



Për:	N.T.SH. "INLINE ENGINEERING" me adresë në Prishtinë
Nga:	Jetulla Kabashi – Menaxher i Prokurimit Komuna e Rahovecit
Lënda:	VENDIM i Kërkesën për rishqyrtim të datës: 30/03/2018
Datë:	04/04/2018

I nderuar z. Valon Hasani – Drejtor,

Autoriteti Kontraktues Komuna e Rahovecit ka pranuar kërkesën për rishqyrtim të datës: 30/03/2018, të pranuar formë elektronike përmesë e-mail adrese: prokurimi.rahovec@gmail.com, nga OE: N.T.SH. "INLINE ENGINEERING" me adresë në Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: **Furnizim me gjenerator dhe pjesë përcjellëse për nevojat e Repartit të Dializës**, me Numër të prokurimit: **623-18-004-1-2-1**, inciuar nga Autoriteti Kontraktues: (AK) – Komuna e Rahovecit.

Kerkesa është REFUZUAR si e pa bazë konform nenit 108/A pika 8.4 të LPP-së.

- Pretendimet tuaj se eshte shkelur:

Neni 7 – Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi,

Neni 58 – Hapja e Tenderëve,

Neni 59 – Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahassimi i Tenderëve.

- Arësyetim:

AK ka konfirmuar se komisioni per vleresimin e tenderit e ka vleresuar sipas kerkesave të dosjes se tenderit dhe ne harmoni me kerkesat e FTD.

Sa i përket pretendimeve tuaja se dokumenti i juaj i Qarkullimit Bankar është dokument i skenuar dhe jo pa vulë, ky dokument qe e keni prezantuar ju është i pavulosur dhe i panënshkruar nga ndonjë bankë e licencuar në Kosovë, ka vetëm llogon e bankës, nuk kemi perdorur nenin. 78 pasi që gjatë Ekzaminimit, Krahassimit dhe Vlersimit te tenderit ka patur ndryshm ne renditje të tenderuesve per shkak te gabimeve aritmtikore.

Konstatimi nr. 1:

1. Hapja e ofertes ka qene me daten 05.03.2018, ndersa formularin e tendeir e ka nenshkru me daten 02.03.2018. Edhe pse ka dhene ne formularin e tenderit 90 ditë llogaritja e diteve fillon prej dates 02.03.2018 pra nuk ka ofertav validitet 90 ditë por vetem 87 ditë.

- Te dosja e tenderit; Pjesa C: Formular për dorëzimin e tenderit, pika 4. thotë – Ky tender është valid për një periudhë prej [90dite] nga data finale për dorëzim të tenderëve, dhe jo nga data kur është plotësuar dosja nga Operatori Ekonomik.

Konstatimi nr. 2:

2. Duke u bazuar ne LPP Neni 58 Hapja e tenderit tek paragrafi 3, ne pershkrim te ektij paragrafi kerkohet qe Ne çdo rast, secila faqe e çdo tenderi financiar do të nënshkruhet gjatë hapjes publike nga një përfaqësues i një ofertuesi tjetër.

Prandaj gjatë qasjen në oferten e operatorit ekonomik te shpallur fitues kemi verejtur se oferta finansare nuk eshte e nënshkruar nga nje përfaqësuesit i një ofertuesi tjetër, sic ka vepruar ne formularin e tenderit.

- Edhe ky konstatim i juaj është i padrejtë sepse të gjitha ofertat që kanë qenë kopje fizike janë të nënshkruara nga përfqësuesi i një ofertuesi tjetër.

Gjatë hapjes së tenderit kemi patur pesë (5) Ofertues, Një (1) Elektronik dhe Katër (4) në kopje fizike, ku gjatë hapjes së ofertave kemi patur prezent vetëm Dy (2) përfaqësues të Ofertuesve. Edhe ju si O.E. N.T.SH. "INLINE ENGINEERING" me adresë në Prishtinë, në qoftë se keni qenë në hapje të ofertave e keni paturë mundësi që të nënshkruani secilen faqe të qdo tenderi financiar të një ofertuesi tjetër, sepse te Kërkesa per Rishqyrtim, neni 4. Procesi i Hapjes së tenderëve - nuk jeni deklaruar se keni marrë pjesë në hapjen e tenderëve.

Konstatimi nr. 3:

3. Ne dokumentin qe eshte paramasa dhe parallogaria ka nderhyrje me dore ne cmime,nuk lejohet që të kete ndryherje me dosjen e OE nga AK.

- Rregullat dhe Udhezuesi Operativ per Prokurimin Publik - Neni 41. Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahassimi i Tenderëve:

41.8 AK do të përmirësojë gabimet plotësisht aritmetike në tender nëse gabimet e tilla zbulohen gjatë ekzaminimit të tenderëve sidoqoftë ky përmirësim nuk mund të jetë më shumë se dy përqind (2%) i vlerës totale të ofertës.

- i. Ne rast se shuma e korigjuar është me pak se +/- 2%, AK do te përmirësoj gabimet e tilla dhe do te informoj me shkrim OE ne fjale duke përdorur formën standarde B49.

Andaj ky ligj na ka obliguar që të bëjmë këtë ndërhyrje dhe të përmirësojmë gabimin aritmetikorë, me tecilën është pajtuar edhe O.E. "BRT" Sh.p.k. me adresë në Prishtinë, për gabimet Aritmitikore, sipas LPP - së.

Konstatimi nr. 4:

4. Deklarata e specifikimeve teknike neni 3.1 Fleta e te dhenave të tenderit nuk e posedone.

Sipas Dosjes se tenderit: Aneksi 1 SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME, nuk është kërkuar deklarta për Specifikimet teknike, po është kërkuar: Katalogu nga prodhuesi ose dilerit te autorizuar për produktin me te cilin oferton.

Konstatimi nr. 5:

5. Ak ka vepruar ne kundeshtime me neni 7 dhe na ka bere diskriminime gjate evaluimit duke mos respektuara rregullat e LPP-së.

- Edhe ky konstatim i juaj është i padrejtë sepse Autoriteti kontraktues i ka trajtuar të gjitha operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe ka vepruar në mënyrë transparente.

Kjo procedurë eshte trajtuar konform Ligjit Nr. 04/042, Ligji për Prokurimin Publik ne Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92.

-Kundër ketij vendimi të AK ju munde të paraqitni ankesë pranë OSHP-së në pajtim me nenin 109 të LPP-së.

Me respekt

Jetulla Kabashi

Shef i Zyres se Prokurimit - Komuna e Rahovecit.



Adresa: Rr."Xhelal Hajda - Toni" p.n. 21000 Rahovec
Tel: 045 884 536 e-mail: prokurimi.rahovec@gmail.com

1/2